

DEMIR ZYKOJA – KY LIS TIMBRIK I ISO-POLIFONISË SHQIPTARE

Viktor BAKILLARI

Studiues, Akademia “Rrënjët Tona”

PËRMBLEDHJE

Në këtë artikull trajtojmë çështje të iso-polifonisë shqiptare, duke u përqendruar te ajo tomorricare-skraparase, konkretisht te përfaqësuesi më spikatur i krejt polifonisë toske, Demir ZYKO (1911 – 1992) në gjysmën e dytë të qindvjetëshit të 20-të (1950 – 1990). Fillimisht trajtojmë shtratin historiko-polifonik ku u formua këngëtari shqiptar Demir Zyko. Më poshtë analizojmë zërin dhe performancën e artistit në skenë, karakteristikat dhe veçoritë e rralla të zërit të tij. Më tej, pasi japim disa mbresa lidhur me virtuozin, kalojmë në analizën e rreshtëpërreshtshme të këngës emblematike “Mbeçë more shokë, mbeçë”, duke u përqendruar dhe analizuar me kujdes vargun ritmik “Përtej urës së Qabesë”. Këtu shprehim mendimin tonë të argumentuar se fjala “urë” nuk është fjala e duhur, e cila mendojmë se është kënduar dhe shkruar gabim. Në vend të saj, do të duhej të ishte një fjalë tjetër.

Fjalë kyçe: Iso-polifoni; Demir Zyko, Tomorricë, Skrapar, kënga “Mbeçë more shokë, mbeçë”, “Ura e Qabesë”.

ABSTRACT

In this article we address issues of Albanian iso-polyphony, focusing on that tomorricare-skraparase, specifically the most prominent representative of all Tosk polyphony, Demir ZYKO (1911 - 1992) in the second half of the 20th century (1950 - 1990). First we treat the historical-polyphonic bed where the Albanian singer Demir Zyko was formed. Below we analyze the voice and performance of the artist on stage, the characteristics and rare features of his voice. Next, after giving some impressions about the virtuoso, we move on to the linear analysis of the emblematic song "Mbeçë more shokë, mbeçë", focusing and carefully analyzing the rhythmic verse "Beyond the bridge of the Kaaba". Here we express our reasoned opinion that the word "bridge" is not the right word, which we think has been sung and misspelled. Instead, it should be another word.

Key words: Iso-polyphony; Demir Zyko, Tomorricë, Skrapar, the song “Mbeçë more shokë, mbeçë”, “Ura e Qabesë”.

HYRJE

Tomorrica, sot (2021) e braktisur, ka pasur shkëlqim të rrallë qysh, e pakta, nga mesjeta e gjer në vitet 1990. Ajo, e banuar qysh në lashtësi, ka faqe të ndritura historie edhe pse pak të njohura. Kështu, për shembull, ka të dhëna (ndonëse të pakta) për kalatë ilire të Gradecit, të Gurit të Prerë, të Shëmbërdhenjit, për atë të Tërrovës e cila është një çudi më vete, ndoshta shkon deri në antikitetin e hershëm. Familja Muzaka, sipas dokumenteve të shkruara nga dora e pinjovje të kësaj dere, e kishte Tomorricën qilarin e pasurisë së saj, pasi aty kishte edhe damarin e saj të floririt (arit). Tomorricën e përshkonte një degë e Egnatias (Apoloni – Berat – Qafa e Dardhës, Tomorr – Tomorricë – Opar – Korçë, e cila funksiononte, edhe gjatë mesjetës ku Venediku çonte mallrat e tij në Voskopojë e më tej, në Grebene e Selanik, por askush nuk ka thënë asnjë fjalë të saktë për të, nëse ajo ishte rrugë qerresh apo thjesht karvanësh me kuaj ngarkese.

SHTRATI HISTORIKO-POLIFONIK KU U FORMUA KËNGËTARI TOMORRICAR DEMIR ZYKO

Që para 300 e ca vjetësh, eksploratori osman Evliha Çelebiu (Stamboll, 25 mars 1611- afro1682) thotë

se në malin e Tomorrit vinin nga Evropa për barërat shëruese të këtij mali. Në Tomorricë, për shkak të dendësisë së dikurshme të popullsisë, ku ngriheshin 500 luftëtarë njëherësh, dhe të grumbullimit në të shtresave të të pasurve, ka pasur edhe përplasje të fuqishme me Portën e Lartë. Ato nuk kanë qenë thjesht pakënaqësi historike, por kryengritje të mëdha, si ajo e vitit 1570, e udhëhequr nga i pari i Tomorricës, Hamza beu nga Grëmshi, i cili synonte të vinte nën sundim Skraparin, Oparin e Vërçën, por pas disa vitesh përpjekjesh, rrethohet në Berat dhe e syrgjynosin në Edrene. Një kryengritje tjetër e fuqishme, që këtë radhë përfshiu edhe krahinat e Skraparit, Dangëllisë, Oparit, Vërçës ishte edhe ajo viteve 1699-1717 me rreth 46 prijës luftëtarë, por që përmenden në fermanët e sulltanit si më të rrezikshmit Mehmet Allka, Mustafa Osmani dhe Muço Beqiri, që të tre nga Grëmshi. Për shtypjen e kryengritjes, sulltani dërgoi katër pashallarët më të dëgjuar: Hodaverdi Pashën, Adem Pashën, Sejfulla Pashën, Ali Pashën me mbi 10 000 ushtarë. Kryengritja u shtyp pas rreth 20 vjetësh. Por populli i kësaj krahine nuk e reshti luftën. Një tjetër kryengritje që u lidh me Tanzimatin është ajo e viteve 1828-1842, që përfshin Skraparin, Tomorricën dhe shtatë krahina të tjera si Dëshnicën, Mallakastrën e Sipërme dhe e Poshtme, Tepelenën, Vlorën, Vërçën dhe Sulovën. Që andej, prej shumë kohësh, vjen kënga kushtuar udhëheqësit të kësaj kryengritjeje, Sade Straficës: “*Dyzet fshatra Tomorrica, /aspirant Sade Strafica*”. Gjithë këto luftëra të bëra edhe në Tomorricë përfundonin me shtypje të dhunshme. Eksponentët që mbeteshin gjallë, o largoheshin, o kapeshin dhe vriteshin, o syrgjynoseshin e dërgoheshin dhunshëm nën nizamë, prej nga, më vonë populli i asaj treve u ngrinte këngë. Por, që t’i ngrihej dikujt këngë, ky duhej të ishte trim i çartur. Kënga, shpesh herë ngrihej pasi e kishe paguar me kokë. Por, që kjo këngë të jehonte e të përcillej, duheshin rapsodë të talentuar, duheshin këngëtarë virtuozë, duheshin këngëtarë të mëdhenj. Dhe Tomorrica ka pasur denbabaden të tillë. Asnjëherë nuk i ka munguar gjenia krijuese dhe interpretuese e ngjarjeve në këngë. Fatkeqësia qëndron se nuk ka pasur as shkrim e këndim, as mjete të ruajtjes e konservimit të zërit. Megjithatë, tradita e përcjellë gojore, gjithnjë na ka rrëfyer se Tomorrica ka pasur këngëtarë të mëdhenj.

Kohët e fundit (Mars, 2021) “zbulova” diçka të re. Në një bisedë me z. Asqeri F. Diko nga Zaloshnja (burrë dhe burim i besueshëm, prej shumë vitesh shpërngulur në Stamboll), ai rrëfen:

“Në vitet 1920 në Zaloshnjë ishin shpërngulur nga Greva dy vëllezër: Selim e Rakip Avdullai, të cilët ishin këngëtarët më të mirë thujse në Tomorricë. Rreth fundit të viteve 1940, ikën nga Zaloshnja dhe shkuan në Cërrik. Këta dy vëllezër, kur ia merrnin, mbanin në xhep tre–katër gurë të vegjël që shoqëronin këngën me tingujt që dilnin nga gurët. Shumë interesante! Pra, gurët, ishin në vend të instrumentit muzikor. Kamberi (djali i Selimit), tashmë është banues në Tiranë tek e bija që është mësuese e anglishtes. Kur ia merrnin këngës ata dy vëllezër bashkë me Feimin (tim atë) apo me bashkëfshatarë të tjerë të Zaloshnjes, mblidhej krejt fshati e kënaqej. Baki Çela ka shkruar për ata”. Pak më vonë, rreth viteve 1940, lugina e Tomorricës ka ushtuar nga një zë tjetër i fuqishëm, nga ai i Fetah Gurrazetit, këngëtar dhe valltar i talentuar i viteve 1930–1940. Vite më pas kanë oshtirë zëra të tjerë, që nëse do të kishte mjete incizimi e filmimi, do të ishin një gjerdan i artë i polifonisë sonë. Pothuaj se çdo fshat tomorricar ka pasur virtuozët e vet. Të tillë ka pasur që nga Gjokovica e Kuçi gjer në Shëmbërdhenj e Ermënj, që nga Mëlova e gjer në Tërrovë. Dukej sikur burrat e parë të fshatrave të Tomorricës ia merrnin dhe lumi gurgullues u shërbente si iso e pandërprerë. Këngëtarë të mëdhenj ka pasur edhe një nga kryeqendrat e Tomorricës: Gjerbësi. Ka qenë i dëgjuar shumë Jahja Sheme Flamuraj (1871-1955), i njohur me emrin Jak, mjeshtëria zanore e të cilit ka qenë e vlerësuar në krejt zonën e më gjerë, gjer te bejlerët e Delvinës, e që nami i tij vjen deri sot.

Në këtë shtrat këngëtarësh me emër është rritur edhe Demir Zykoja. Me siguri, ai ka trashëguar nga të parët e vet dhe të krejt krahinës melodinë dhe kadencën (ritmin e brendshëm) të këngës, mënyrën e marrjes dhe pikat kulmore gjatë këngëtimit. Pra, ai është produkt i trashëgimisë së paraardhësve të tij, në kushte relativisht moderne të kohës në të cilën punoi e jetoi. Këngëtari Zyko është produkt i një universi natyror shumë të çuditshëm. Përpara shtëpive të xha Demirit shtrihej një fushë e madhe shumë,

ndoshta 3-4 km larg në vijë ajrore: Dumbrava (që mund të kthehej në “Hambar i Tomorricës”), poshtë këmbëve të tij shushurinte, gurgullonte, shkurt shumicën e vitit ison te lumi i Tomorricës. Sipër shtëpisë së tij, gjithashtu ishte një univers tjetër i përbërë nga gjelbërim, pyje të virgjër, shkëmb, mal, dëborë. Demir Zykoja ishte bir tomorricari, ishte bir Tomorri me dhunti zëri jo mbi normalen, por të jashtëzakonshme- thonë akademikë (V. Tole), specialistë e kompetentë të muzikës (T. Daija, B. Lapi, N. Kasoruho, Zh. Ciko etj.) pre-dhe-postmortum (të) xha Demirit. E thonë njerëz me ndjeshmëri të epërme ndaj fjalës dhe tingullit (Xh. Spahiu), e thonë studiues, shkrimtarë e njerëz të tjerë të artit.

ZËRI I D. ZYKOS – DUKURI QË GATI NUK E NJEH SHKENCA E MUZIKËS

Demir Zykoja ka hyrë në analet dhe arkivat e muzikologjisë shqiptare për zërin e tij mbresëlënës. Përshkrimi pamor i D. Zykos, duke qenë se fotografia është statike dhe mund të soditet me kërshtëri, apo mund të ndiqet nëpër filma të arkivuar, nuk përbën ndonjë interes të madh. Veçantia për këtë njeri qëndron te zëri i dashur përvetebërës disaoktavësh. Ne, jospecialistët në lëmin e muzikës, e ndiejmë, por nuk mund ta përshkruajmë ashtu siç duhet. Për të arritur këtë, kërkohet diplomë konservatori, ose duhet të jesh kritik muzikologjie. Për të përshkruar zërin e xha Demirit, kërkohen figuracione dhe terminologji e veçantë, ndryshe nuk mund të arrish në zbërthimin e timbrit ngashënjes, emocional të këtij përfaqësuesi dinjitoz të iso-polifonisë jugore shqiptare.

Zëri i tij, vërejnë studiuesit, është i tillë saqë arrin të përmbysë parimet shkencore gjatë procesit të të kënduarit. Zëri i tij herë burrëror e herë vajtues, herë i ëmbël e herë i mprehtë, herë fushor e herë malor u ka bërë të gjithëve përshtypje. Studiuesit bashkëkohës të këngëtarit, të cilët e ndiqnin nga afër, vërenin se gjatë paraqitjes së tij skenike, teksa këndonte, te zëri i tij hasin një dukuri të rrallë. Kur dikush këndon dhe duhet të çojë zërin në re “përmbi Tomorr”, duhet jo vetëm të mbushet mirë me frymë e të drejtojë trupin, por që zëri të dalë sa më natyrshëm, duhet të ngrejë edhe kokën, të drejtohet dhe të tresë shikimin në një vend mundësisht tutje-lart.

Ndiqeni xha Demirin kur këndon. Të befason me thjeshtësinë, pa asnjë sfrocim; këndon krejt lirshëm e me zë të lartë, me kalime nga njëra oktavë e ulët tek një më e lartë sikur bisedon me zë lirisht, pa aspak vështirësi, madje kryeulur si një kalli plot. Kur të gjithë çirren e drejtohen e ngrihen e ngërdheshin bulçitë dhe u dalin damarët në fyt, sikur fryjnë një kamerdare rrote me frymë, xha Demiri të jep përshtypjen sikur bisedon lirshëm krejt. Kjo dukuri ka befasuar çdo studiues shqiptar muzikologjie. Xha Demiri, mua më avitet në kujtesën fëmijërore (shkollore) si një plak me trup të thantë, si një tomorricar tipik dhe simpatik njëherazi, si prototipi Skraparas, që, vështruar nga larg, të jepte përshtypjen e një njeriu tepër të rreptë e serioz, burrë me mustaqe, burrë zamani dhe zakoni njëkohësisht.

Cilido (piktor, skulptor, antropolog) që dëshiron të sjellë para të tjerëve shqiptarin tomorricar, tiparet dhe veçoritë pamore të tij, prototipin skraparas, Demir Zykoja do t’u shërbente si shembull përgjithësues. Nga zërralli ynë skraparas ka dalë timbri i mahnitshëm, të cilin janë përpjekur ta shkërbejnë me dhjetëra këngëtarë të mëvonshëm të mirë, por që kanë mbetur shumë larg origjinalit, i cili të mbushte trupin gjithë mornica dhe të emociononte deri në përlojtje me “Oi-oi- në” e këngës së tij në ngritje, që niste nga një “Eeeee” e sheshtë e gjatë si fusha e Dumbravës së Grevës (përballë Gjerbësit), që bënte një pushimth - zbritjeje gjer në lumë, që vazhdonte më një “Eee” më të shkurtër që të sjell ndërmend Fushën mbanë lumit të Tomorricës (në Punishte) dhe Brerimën, e pastaj vazhdonte kënga e cila shpaloste gjatë gjithë gjatësisë së saj dallgëzimin e relievit lartor, ngjitej në fshatin e tij Gjerbës dhe merrte përpjetë shkëmbinjve, lajthishtave, pyjeve me lisa, ah e rrebull e përfundonte në majë të Tomorrit me një “Oj-oiiii”, duke u përzier ku me retë e ku me rrezet e diellit për të shkuar në lartësi të pamatshme.

ME XHA DEMIRIN NË TREN

Në vitin 1983 isha nxënës në vitin e dytë në Shkollën e Mesme të Gjuhëve të Huaja “Asim Vokshi”, Tiranë. Në funddhjetor nisnin pushimet dimërore dhe, të gjithë ne nxënësit e rretheve, ktheheshim në shtëpi, te prindërit. Po udhëtoja me tren deri në Lushnjë (pastaj me autobus deri në Skrapar) me një

mësuese letërsie nga Zagoria (emri, megjithëse e pyeta dhe ma tha, fatkeqësisht nuk më kujtohet). Dikush në vagonin tonë kishte ndezur një radio "Iliria". Po transmetohej muzikë popullore. Folësja e radios ftoi dëgjuesit të ndiqnin këngën "*Mbeçë, more shokë, mbeçë*". M'u bë qejfi pa masë dhe gjithë eufori djaloshare i them mësueses zagorite se këngëtarin nuk e kisha më shumë se një orë e gjysmë larg. Kur kthej kokën pas pak, pashë se mësuesja *kullonte në lot*. E pyeta se përse qante e m'u përgjigj gjithë ngashërim se ishte e pamundur që të dëgjoje polifoni skraparase baladë, kënduar nga Demir Zykoja, dhe të mbaje lotët. Nuk mund t'i bësh dot ballë këngëve tuaja të kurbetit, - vazhdoi mësuesja e letërsisë - sado zemërkartik të jesh, pa u shkriret në lot. Sa herë që dëgjoj polifoni të kësaj natyre, sa herë që dëgjoj Demir Zykon tuaj, nuk mund të mbaj dot lotët. Më fal! Gërshetimi i tekstit të baladës me mjeshtërinë e të kënduarit nga artisti Demir Zyko është vërtet prekës dhe mallëngjyes. Xha Demiri shërben si shkollë, si praktikë për të gjithë ata që kanë prirje ose dhunti të kënduari. Xha Demiri iku në korrik 1992, por fatmirësisht, zëri i tij u ruajt, u konservua dhe ai babaxhan i këngës tomorricare-skraparase u shërben të rinjve model që të "ndreqin zënë". Nëse do të hartohej një monografi rreth iso-shumëzanisë popullore, kjo nuk mund të quhej e plotë, nëse në të nuk do t'i kushtohej një kapitull virtuoze nga Tomorrica Demir ZYKO. Demir Zykoja përfaqëson për Tomorricën, për Skraparin për krejt Jugun e Shqipërisë lirin timbrik të iso-polifonisë sonë. Zëri i tij qartë, i pastër, i kulluar si uji i kristaltë i Tomorrit vazhdon të jehojë fuqishëm dhe të studiohet.

ANALIZË E KËNGËS "MBEÇË MORE SHOKË, MBEÇË", KËNDUAR NGA ARTISTI DEMIR ZYKO

Kryekënga e Demir Zykos është "*Mbeçë more shokë, mbeçë*".

Po ç'është kjo këngë? Në vitin 2008, ne kemi botuar librin "*Visare të Skraparit*".

Materialin e mëposhtëm e kemi shkëputur nga ky libër, gjithashtu, mbështetur edhe tek libri i I. Kadaresë "*Autobiografia e popullit në vargje*". (Shtëpia botuese "Naim Frashëri", Tiranë 1980).

BALADA

1. Mbeçë, more shokë, mbeçë

Mbeçë, more shokë, mbeçë, përtej urës së Qabesë! Falë me shëndet nënesë / të më shesë të dy qetë, t'i japë nigjah¹ së resë / Të më shesë kalë e mushkë, / të më rrisë djalë e çupë.

Në pyetit nënia per mua, / i thoni që u martua.

Në u thëntë ç 'nuse mori, / shtatë plumba kraharori. / Në thëntë ç'kali i hipi, / në dy drurë prej mehiti.

Në thëntë në ç'oda e mbyllë / në një odë qereçbina² / pa penxhere, pa baxha.

Por le të ndalemi më gjatë te kjo baladë therëse. Një ushtar, shkon dhe lufton diku larg në Arabi dhe, pasi është plagosur rëndë, në grahmat e fundit lëshon si klithmë në formë thirrori e pasthirrme njëkohësisht:

Mbeçë, more shokë, mbeçë, / Përtej urës së Qabesë!

Fjala fillestare "*Mbeçë*" rimerret në fund të rreshtit enkas për të theksuar gjëmën që e ka gjetur ushtarin. Përsëritja e kësaj fjale fsheh në thellësi një dhembje therëse. Folja njërrokëshe "*mbes*" është shumë e fuqishme, dinamike në ngurtësinë e saj. Ajo është metafizike. Nëpërmjet saj lexuesi nënkupton procesin metafizik, heshtjen, reshtjen e jetës. Ky është dhe kuptimi i fjalës "*mbes*", pra nuk shkoj dot më tej. Gjenialiteti i krijuesit anonim të mrekullon me saktësinë kozmike të fjalëve. Fjalën "*përtej*", jo që nuk mund ta zëvendësojmë dot me asnjë sinonim sado i afërt qoftë (se ndryshe do të kishim bjerrje stilistikore, kuptimore), por dhe nuk mund ta perifrizzojmë më bukur. *Ura e Qabesë* këtu na del si kufi ndarës mes jetës dhe vdekjes. Shoku është këtej *Urës* ndërsa ai *përtej*, pra matanë jetës, në gjirin e vdekjes. Vërtet ura shërben për të lidhur dhe është pleonazëm të thuash *urë lidhëse*, por në këtë rast unik, ura shërben si ndarje botësh. Si të mos mjaftonte konteksti, në këngë kemi dhe fjalën *Qabe*. Kjo

¹ Shumë të hollash që duhej t'i jepte burri gruas në rast se e ndante, sipas rregullave të fesë myslimane; leje.

fjalë të sjell ndër mend dhe anën mistike, shenjtoje të jetës. Qabeja si vend i shenjtë presupozon jetën dhe pjesa përtej saj nënkupton të shkuarët nga kjo botë.

Në çastet e fundit i ziu nizam i gjorë gjen forcë dhe frymën e fundit e harxhon duke shprehur një dëshirë dhe dy porosi.

Falë me shëndet nënesë / të më shesë të dy qetë, / t'i japë nigjah¹ së resë.

Të më shesë kalë e mushkë, / të më rrisë djalë e çupë.

Vargjet janë shumë të fuqishme, të prerë si urdhra, të nxituara e të kursyera, gati si një copë pusullë e shkruar shpejt e shpejt përpara se të ngrijë dora. Ai njofton shokun pa humbur kohë që të vërë në dijeni nënën (*nënen*, në të folurën e Skraparit) që e pret në fshat me mijëra kilometra larg dhe hapat që ajo duhet të marrë pas marrjes së mandatës. Këtu nuk del në pah roli i matriarkatit, por situata e jetës që mbizotëronte aso kohe. Burrat, martoheshin, linin trashëgimtarë dhe largoheshin për t'u siguruar jetën. Dhe kjo monotoni rrënuese, si e parashkruar, trashëgohej nga ati tek i biri. Të njëjtin fat ka pasur, mesa duket, edhe i ati i ushtarit tonë. Me siguri edhe ai ka lënë kockat, ashtu si dhe ky në Jemen, a diku gjetkë. Shitja e qeve ishte porosia e parë e ushtarit që po jep shpirt. Ai është i bindur dhe i ndërgjegjshëm se me shkuarjen e tij përtej *Urës së Qabesë* do të ndryshojë edhe rrjedha ekonomike dhe përbërëse e familjes së tij.

Porosia tjetër ishte shitja e kalit për rritjen e djalit dhe ajo e mushkës për çupën. Nëna dhe nusja presin kthimin e njeriut të tyre të shtrenjtë, ndërsa ai u shkruan një pusullë, që ata duhet të shesin pasuri e katandi. Edhe fjala "*së resë*" është shumë e goditur. Në poezi nuk jepet sinonimi i saj "*nuse*" (grua e re e sapomartuar), pasi ajo ka lindur dy fëmijë, as sinonimi tjetër "*grua*" (femër me moshë të pjekur që dallohet nga vajza), por diçka e ndërmjetme mes të dyjave: *e reja*. Rreshti *të më rrisë djalë e çupë* është po ashtu shumë i goditur. Misioni i babait ushtar para se të largohej nga vatani quhet i përmbushur. Djali dhe vajza janë simboli i çiftit për vazhdimësinë e jetës. Edhe rendi i tyre është domethënës dhe siç do t'ia kishte ënda çdo burri shqiptar. Në fillim djali për vazhdimësinë e emrit dhe për të ndihmuar motrën dhe, pastaj, vajza. Në mënyrë jo të drejtpërdrejtë jepet njëfarë ndarjeje e pasurisë: kali për djalin dhe mushka për çupën. Dhe është logjike kjo lloj ndarjeje për mendësinë e shqiptarit.

Pastaj vijon pjesa e dytë e këngës:

Në pyetit nënia për mua, / i thoni që u martua.

Këtu dhimbja është e tmerrshme dhe sheshit. Këto dy vargje të përzier me autoironi të skajshme si nënqeshje prej shpirtdhënësi fshehin vdekjen. Nuk di ndonjë gjuhë tjetër ku vdekja të ketë për sinonim kontekstual martesën. Është e natyrshme që, pasi nëna të ketë mësuar për martesën e të birit, shfaq interes për hollësitë e dasmës: për nusen, për kalin (tradita jonë që nusen e marrim mbi kalë) dhe për krushqit. Dhe ushtari që i njeh mirë traditat dhe zakonet e vendlindjes, nuk vonon t'u japë përgjigje tri kureshtjeve të nënës së gjorë.

Në u thëntë ç'nuse mori, / shtatë plumba krahërori.

Dhe tani, pasi nëna e mori vesh të vërtetën, do të donte të merrte vesh të gjitha hollësitë e tjera. Duke ditur merakun e nënës, ushtari, sikur të merrej vesh në mënyrë telepatike me të, dhe sqaron më tej:

Në thëntë ç'kali i hipi, / në dy drurë prej mehiti.

Dhe fundi tragjik i këngës:

Në thëntë në ç'oda e mbyllë, në një odë qereçbina² / pa penxhere, pa baxha.

Te këta vargje të cilët përbëjnë dhe epilogun e këngës ia vlen të ndalemi disi.

Një variant tjetër mbyllet me vargjet:

Në pyestë se ç'krushqë vane / Sorrat dhe korbat e hanë.

Ky është një variant tjetër popullor (gjithashtu i bukur), por jo i Skraparit. Dasmës shqiptare me nusen stolisur me vello të bardhë, me krushq të veshur bukur, me fustanella e me qeleshe të bardha, me orizin si simbol të shtimit (të pjellorisë), me kuaj, me muzikë (këngë) krijuesi anonim i vë përballë një tufë

² (Këtu:) Në varr.

shkabash, sorrash e korbash që në vend të këngës kanë krrokëllimat duke u zënë se kush e kush t'i nxjerrë sytë e para ushtarit. Në variantin e Skraparit kemi një botë krejt tjetër nga kjo e mësipërmja. Në këtë variant shmanget episodi i krushqve, a thua sikur djali ka përdorur dredhinë pellazgjike, atë të rrëmbimit të nuses dhe i kushton rëndësi të madhe çastit më sublim të kurorëzimit të dasmës: atij të mbylljes së dhëndrit në gjerdek. Gjerdeku, dhoma e shtruar për dhëndrin e nusen natën e parë të martesës, është një element thelbësor, i patrajtuar në variantet e tjera. Nata e gjerdekut si elementi kryesor i martesës përshkruhet mjeshtërisht në variantin e Skraparit dhe s'kishte sesi të ndodhte ndryshe. Atë (dhëndrin) e mbyllën në një odë të lyer me qereç (gëlqere) pa asnjë dritare a kapanxhë që të mos ketë mundësi të hyjë as dhe rrezja e diellit. Intimitet më të plotë nuk ka. Përshkrim metaforik më të bukur e më mbresëlënës për varrin sesa këta vargje, zor se mund të gjesh. Por ka edhe më. Në variantin jo të Skraparit është zhvilluar pothuajse e njëjta bisedë midis ushtarit të plagosur për vdekje dhe shokut të tij. Por autori i variantit tjetër, siç u tha më lart, i jep një fund tjetër vdekjeje, atë të asgjësimit pa nam e pa nishan. Mbi kurmin e ushtarit që është duke dhënë shpirt, do të kërcejnë vallen mortore sorrat dhe korbat dhe shoku i tij s'ka mundur ta varrosë. Ndërsa në variantin e Skraparit kemi rrokullisje të tjera ngjarjesh. Shoku i tij i gjendur pranë, jo vetëm që ka marrë amanetet e tij dhe ia ka plotësuar, por ka kryer edhe atë që quhet respektimin e të ndjerit. Shoku, jo thjesht e ka varrosur, i ka hedhur dy grushte rërë (në Arabi s'mund të flitet për dhe, por i ka ndërtuar një varr madhështor, një monument gjigant do të thoshim pa e zmadhuar se vetë fjala e përngjitur *qereçbina* këtë kuptim ka. Fjala *bina* do të thotë ndërtesë e madhe. Edhe pjesët përbërëse të fjalës *qereçbina* janë shumë kuptimplota. Varrin krahasohet me tempullin. Për të dhënë përmasat e varrit gjigant do të përmendim një fjalë të urtë popullore: *Binaja s'mbahet pa shtylla*. Dhe kjo bina është e ndërtuar me qereç. Kuptimi i fjalës *qereç* është mur i ndërtuar me gurë e me llaç gëlqereje që bëhet shumë i fortë. Monument më të bukur dhe më domethënës për një që vdes nuk do të kishte. Të jepet përshtypja se ai varr do të kthehet në faltore.

Në këtë këngë flitet për vdekjen, por vdekja nuk përmendet asgjekundi. Përkundrazi në të mbizotërojnë fjalët martesë, nuse, kalë, krushq. Është vërtet madhështore që në këtë atmosferë me "humor të zi" sundon dasma. Por ku mund të jetë krijuar kjo këngë? Këtu në Shqipëri apo në rërat arabike? Jemi të mendimit se mund të jetë krijuar nga shqiptarët ushtarë në Jemenin e largët duke u nisur nga komenti që u bëmë tre rreshtave të fundit. Ushtari që ka varrosur shokun *përtej Urës së Qabesë*, pasi ka marrë amanet-porositë e tij për nënën e gjorë i kanë bërë shumë përshtypje fjalët e tij të fundit dhe rrugës për në atdhe, i sfilatur nga rruga e gjatë dhe e lodhshme, në mënyrë të vetvetishme ka krijuar vargjet magjepsëse që me siguri dhe pa e zmadhuar aspak mund të përbënin një nga perlat e baladave, jo vetëm shqiptare, por dhe mbarëbotërore. Dhe kjo baladë-simbol i këngëve të nizamëve është kënduar prej zërrallit tomorricar, skraparas, Demir Zyko.

ANALIZË E VARGUT "PËRTEJ URËS SË QABESË"

Te vargu *Përtej urës së Qabesë* dëshirojmë të ndalemi një grimë. Kënga na është transmetuar e shkruar me fjalën **urë** dhe komentin e bëmë sipas kësaj fjale. Kjo fjalë duhet të ketë një përdorim metaforik siç do ta sqarojmë më poshtë. Për lexuesin e thjeshtë, apo dhe për specialistin gjithçka duket normale dhe është në të vërtetë e tillë. Arabia (Qabeja) është një vend i largët dhe ashtu siç thotë kënga, *Përtej urës së Qabesë*, ashtu duhet besuar. Mirëpo, nëse do të thelloheshim pak, do të dëshironim të bënim këtë pyetje: Duke ditur se elementi kryesor në Arabi është rëra, thatësira, shkretëtira e stërmadhe, të gjitha këto baras me mungesën e ujit, si mund të ndërtohet një urë në një vend të shkretë, në një vend që s'kalon lumë? Pra jemi të mendimit se fjala *Urë* mund të jetë *patjetër* diçka tjetër ose një deformim i ndonjë fjale tjetër. Atëherë si shpjegohet Përgjigjet e mundshme, sipas mendimit tim, janë tri:

1. Ka mundësi të jetë *Përtej Udhës së Qabesë*. Kjo është dhe mundësia më e madhe. Udhë që të çon në Qabe simbolizon jetën, ndërsa përtej saj është mbretëria e vdekjes.
2. Mund të hamendësojmë gjithashtu se duhet të ketë qenë *Përtej gurës (gurajës) = Përtej Gurit të Qabesë*. Për ata që mëtojnë ta hedhin poshtë këtë mendim duke thënë se fjala **gur** është e gjinisë mashkullore, do të mund të thoshim se në gjuhën shqipe kjo fjalë na del në disa krahuina, si për

shembull në atë të Korçës, si emër familjeje në femërore (kemi parasysh, për shembull, emrin Milto – Sotir Gura). Po kështu ekzistojnë edhe toponime të femërorizimit të emrave të gjinisë mashkullore. Kështu për shembull kemi në krahinën e Matit fshat me emrin Gurabardh në vend të emrit në gjininë mashkullore Guri i Bardhë. (Kuptimi është i njëjtë: Gur me ngjyrë të bardhë). Po kështu në Fjalorin e Gjuhës së Sotme Shqipe, Tiranë 1980, fq. 590, kemi disa fjalë të përbëra me fjalën **gura**. Ndër më kryesoret është fjala **Guraj-ë, - a, f. sh. – a, -at. Vend me gurë; gurishtë**.

3. Po ka mundësi, ndoshta, të ketë qenë edhe: **Përtej gurrës = Përtej Burimit të Qabes**. Fjala gurrë është mbarëpopullore. Sipas G. Majerit, fjala γούρβα (gurna = **gurrë**) ka kuptimin **pellg burimi** (bassin d'une fontaine). Shumë pranë Qabesë buron një ujë i tillë që njihet me emrin **Zemzen**. Nëse rreshti i këngës do të ishte **përtej gurrës së Qabesë** = matanë ujit të Qabesë, lexuesi e nënkupton lehtë se përtej kësaj gurre = burimi = uji, fillon shkretëtira = etja = vdekja.

PËRFUNDIME

1. Të duam, të respektojmë dhe të ngremë lart figurat muzikologjike me ndikim kombëtar, në rastin konkret, artistin e popullit, Demir Zyko.
2. Të shkruajmë, të mbrojmë dhe të përhapim iso-polifoninë, si pjesë e tabanit, e këngëve më të moçme shqiptare.
3. Të studiojmë dhe të shkruajmë për iso-polifoninë popullore shqiptare, e cila për vlerat e epërme në muzikologji është shpallur “Kryevepër e trashëgimisë gojore të njerëzimit”, e mbrojtur nga UNESCO-ja (2005).
4. Balada e mërgimit “*Mbeçë more shokë, mbeçë !*”, në vargun e dytë thotë: “*përtej urës së Qabesë!*”. Ne, gjatë shqipëllimit tonë kemi hedhur mendimin se **nuk** mund të ketë urë në Qabe dhe kemi dhënë argumentet tona se si mund të qëndrojë çështja.

STUDIME MBËSHTETËSE DHE REFERENCA

1. **Kadare**, Ismail: “*Autobiografia e popullit në vargje*”; Shtëpia botuese "Naim Frashëri", Tiranë 1980),
2. **Bakillari**, Viktor: “*Visare të Skraparit*”; Shtëpia botuese “Albatros”, Tiranë, 2008.